



Komuna e Gjakovës



KRM "ÇABRATI"

MARRËVESHJE BASHKEPUNIMI

për Mirëmbajtjen e Autorrugëve

E lidhur me datën 24.12.2021 ndërmjet palëve:

1. Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini, në tekstin vijues theksohet: Komuna.
2. Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "ÇABRATI", të cilën e përfaqëson z. Behar Ferizi, Kryeshef Ekzekutiv i KRM "ÇABRATI", në tekstin vijues theksohet: KRM "ÇABRATI".

Neni 1

Baza ligjore e marrëveshjes

Komuna e Gjakovës në bazë të nenit 58 pika b të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 9 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, arrihet marrëveshja me Kompaninë Regjionale të Mbeturinave KRM "ÇABRATI" **për mirëmbajtjen e autorrugëve**

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është mirëmbajtja e autorrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës për krijimin e një ambienti sa më të pastër.

Neni 3

Detyrimet e palëve

3.1. KRM "ÇABRATI" obligohet të bëjë pastrimin me autofshesë dhe punëtoret me fshesa, larjen me presion autocisternë, mbledhjen e mbeturinave nëpër shporta dhe përreth trotuareve, zbrazjen e të gjitha shportave të vogla nëpër rrugë publike, pastrimin e baltës deri tek ujëmbledhësit, spërkatjen e rrugëve me cisternë sipas kërkesës, mbledhjen e kafshëve të ngordhura dhe varrosjen e tyre sipas kërkesës, pastrimin e ujëmbledhësve sipas kërkesës, pastrimin e lumit Krena, larjen e rrugëve me presion sipas kërkesës.

3.2. Komuna do të bëjë pagesën sipas fletë dërgesave, faturave dhe çmimorës së përcaktuar në lista me paramasa.

Neni 8

Pjesë e kësaj marrëveshje është edhe lista me paramasa dhe me çmime për mirëmbajtjen e autorrugëve.

Neni 9

Kjo Marrëveshje është e përpiluar në katër (4) kopje, prej të cilave nga dy (2) kopje iu dorëzohen palës kontraktuese.

PALËT



Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës



Behar Ferizi

Kryeshëfi Ekzekutiv i KRM "Çabrat"